



A K T - T H E M E L U E S

I S H O Q E R I S E T R E G E T A R E

“SHPETIM XIBRAKU” SHPK

Ne mbështetje të nenit 2 paragrafi 1, shkronja “ç” të ligjit të Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë nr. 7512 datë 10/08/1991 “Per sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lire të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, Ligjit 7638 datë 19.11.1992 “Per Shoqëritë Tregëtare”; Ligjit 7594 datë 04.08.1992 “Per investimet e huaja” dhe mbi bazën e ligjit 7667 datë 28.10.1993 “Per Rregjistrin Tregëtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqëritë Tregëtare”, personat private:

SHPETIM XIBRAKU , ZELIHA XIBRAKU

U MORREM VESH DHE KONTRAKTUAM per sa vijon:

FORMIMI

Neni 1

Formohet Shoqëria Tregëtare me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin “SHPETIM XIBRAKU” SHPK.

SELIA

Neni 2

Selia e Shoqërisë Tregëtare “SHPETIM XIBRAKU ” SHPK. është në qytetin e Tiranës rr. “Elbasanit” pranë Varrezave të Deshmorëve.

KOHEZGJATJA

Neni 3

Shoqëria Tregëtare “SHPETIM XIBRAKU” SHPK. ka një kohezgjatje të veprimtarisë ekonomike të pakufizuar dhe mbi 10 vjet.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Neni 4

Objekti i veprimtarisë ekonomike të Shoqërisë Tregëtare “SHPETIM XIBRAKU ” SHPK është sipas përshkrimit që bëhet në nenet e Statutit të kësaj Shoqërie.

KAPITALI I SHOQERISE

Neni 5

Kapitali fillestar i Shoqërisë Tregëtare “SHPETIM XIBRAKU ” SHPK është prej 100 000 Leke i përbërë nga si vijon nga ortakët themelues të shoqërisë

PERQINDJET

SHPETIM XIBRAKU me 50% të kuotave
ZELIHA XIBRAKU me 50% të kuotave

Neni 6

Kuotat e pjesemarrjes ne kapital jane te gjitha te emertuara e te pandashme. Ato nenshkruhen, shlyhen plotesisht dhe pastaj ndahen midis ortakeve sipas perpjestimit te pjesemarrjes te secilit ne formimin e kapitalit.

ORGANET DREJTUESE

Neni 7

Organet drejtuese te Shoqerise jane Asambleja e Shoqerise dhe Shoqeria ka administrator te saj **SHPETIM XIBRAKU**.

Fusha e veprimit, perberja dhe menyra e punes se organeve drejtuese, emerimi e shkarkimi i anetareve dhe çeshtje te tjera te rendesishme te ketyre organeve rregullohen sipas Statutit te Shoqerise qe eshte pjese perberese e ketij Akti si dhe ne rregullore te tjera te brendeshme te Shoqerise qe do te miratoje Asambleja e saj.

Neni 8

Shoqeria Tregetare ka zgjedhur si Administrator saj **SHPETIM XIBRAKU**.

Neni 9

Shoqeria Tregetare zbaton edhe dispozita normative urdheruese te Ligjit 7638 date 19/11/1992 "per Shoqerite Tregetare".

Neni 10

Shoqeria ka vulen e Saj zyrtare me permbajtje:
Shoqeria Tregetare "SHPETIM XIBRAKU SHPK.Tirane

MAREDHENIET E PUNES

Neni 11

Maredheniet e punes ne Shoqerine Tregetare rregullohen sipas artikujve te Statutit te saj.

BILANCI DHE TE ARDHURAT

Neni 12

Veprimet ekonomiko-financiare te Shoqerise Tregetare mbyllen me 31 dhjetor te çdo viti. Ne fund te çdo periudhe ushtrimore administratori nxjerr bilancin kontabel te Shoqerise me rezultatin ekonomik Fitim-Humbje bazuar ne ligje e rregulla per mbajtjen e kontabilitetit nga subjektet ekonomike duke nxjerre gjithashtu inventaret perkatese mbi gjendjen e pasurise se Shoqerise si dhe raportin mbi administrimin.

Bilanci kontabel vjetor miratohet nga Asambleja e Shoqerise.

Me miratimin e bilancit vjetor Asambleja vendos krijimin e fondeve te ndryshme te nevojshme per zhvillimin e garantuar te saj.

Neni 13

Fitimi I realizuar nga Shoqeria Tregetare pas veçimit te fondeve dhe detyrimet fiskale ndahet ne mes ortakeve te saj ne perputhje me raportin e kuotes se secilit ortak ndaj kapitalit themelor te Shoqerise.

SHPERBERJA E SHOQERISE

Neni 14

Shperberja e Shoqerise Tregetare mund te vije ne çdo kohe dhe per çfaredolloj shkak, duke vepruar sipas kriterëve te pershkruar ne Statut.

DISPOZITAT E PERGJITHESHME

Neni 15

Te gjithë kundershtimet eventuale midis ortakeve te Shoqerise zgjidhen nga Gjykata e Tiranës, vendimet e te ciles jane te formes se prere. Ortaket per zgjidhjen e mosmarreshjes midis tyre mund te zgjedhin edhe procedura te tjera te miratuara nga Asambleja e Shoqerise dhe te zbatueshme .

Neni 16

Ky Akt - themelues (Kontrate) perpilohet ne disa kopje per t'iu shperndare organeve kompetente: Gjykates se Rrethit per njohjen si person juridik dhe regjistrimin ne regjistrin tregetar dhe nje kopje mbetet si pjese perberese e dokumentacionit te themelimit te shoqerise Tregetare . Kontrata firmoset rregullisht nga ortaket themelues te Shoqerise Tregetare "SHPETIM XIBRAKU"

SHPK

SHPETIM XIBRAKU

Shpetim Xibaku

ZELIHA XIBRAKU

Zelisha Xibaku

REPUBLIKA E SHQIPERISE

DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 26/7 Rep

VERTETIM

Sot, me daten 25.06. 2003 ne Dhomen e Noterise Tirane , para meje noteres Luljeta Kongoli ,u paraqiten personalisht : **SHPETIM XIBRAKU** , i biri i Fadilit , lindur me 27.10.1972 ne Tirane , banues ne Tirane , rr"Mustafa Lleshi" pll.18, **ZELIHA XIBRAKU**, lindur me 1949 , banuese ne Tirane , ne adresen e mesiperme, te cilet pasi mu bene te njohur, une noteria i vertetoj nenshkrimin sipas ligjit.

**NOTERE
LULJETA KONGOLI**

Luljeta Kongoli



STATUT

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUARA

"SHPETIM XIBRAKU"

FORMA EMERTIMI ,OBJEKTI ,SELIA,KOHEZGJATJA

NENI 1

FORMA

Formohet ne Tirane Shoqeria Tregtare "SHPETIM XIBRAKU " sh.p.k.
Ajo eshte Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar dhe ka ortake themelues:
SHPETIM XIBRAKU dhe ZELIHA XIBRAKU.

Neni 2

EMERTIMI I SHOQERISE

Emri i Shoqerise do te jete "SHPETIM XIBRAKU " sh.p.k.

Neni 3

SELIA E SHOQERISE

Shoqeria "SHPETIM XIBRAKU " sh.p.k., Seline e ka ne Tirane , rr"Elbasanit "Prane Varerzave te deshmoreve. Me qellim te realizimit te veprimtarise ajo do te hape filjale ne rrethe te tjera te vendit.

Neni 4

KOHEZGJATJA

Afati i veprimtarise se Shoqerise do te jete mbi 10 vjet .Si date fillestare meret data e regjistrimit te saj si person juridike Gjykatene Rrethit.

NENI 5

OBJEKTI I VEPRIMTARISE


Shoq. "SHPETIM XIBRAKU "SHPK ka objekt te veprimtarise se saj keto fusha,
- Ne -Aktivitet ne fushen e , Hotelerise dhe Turizmit, Bareve dhe Restoranteve.

Tregtimin e artikujve te ndryshem industrial, ushqimor, bujqesor ,materiale ndertimi dhe elektrike , mobileri, lende drusore, kanceleri te ndryshme, kozmetike , konfeksione , metrazhe , me shumice e pakice import eksportin e tyre -Hapje agjensish turistike .

KAPITALI THEMELTAR , TRANSFERIMI I KAPITALIT THEMELTAR

KAPITALI THEMELTAR

Neni 6



Shoqeria "SHPETIM XIBRAKU" sh.p.k themelohet me nje kapital themeltar prej 100.000 leke. Ai mund te shtohet dhe pakesohet sipas vendimit qe do te marre Asambleja e Ortakeve. Kpaitali themeltar eshte I ndare ne menyre te barabarte mes ortakeve te saj, Sheptim Xibraku me 50% , dhe Zeliha Xibraku me 50%.

Neni 7
FITIMI

Fitimi i realizuar nga aktiviteti i Shoqerise i takon ortakeve te shoqerise

Neni 8
MARJA E VENDIMEVE

Te gjitha Vendimet ne shoqerine "SHPETIM XIBRAKU" meren nga me votimin e te dy ortakeve SHPETIM XIBRAKU, ZELIHA XIBRAKU.

Neni 9

LINJA E TRANSFERIMIT TE PJESEVE TE TJERA TE KAPITALIT

Kapitali i shoqerise eshte lirisht i transferueshem ne radhe te pare midis ortakeve dhe me pas tek personate trete nqs. Asambleja e Ortakeve vendos per kete qellim , po ashtu eshte lirisht i transferueshem dhe ne rruge trashegimie dhe ne cfaredolloj forme te parashikuar nga Ligji .Transferimet e pjeseve te kapitalit vertetohen nga noteri.

NENI 10
STRUKTURA JURIDIKE ,DREJTIMI DHE ADMINISTRIMII SHOQERISE

Administrator i Shoqerise ,do te jete SHPETIM XIBRAKU .


Neni 11
Asambleja e Ortakeve miraton llogarite pas raportit te ekspertit kontabel te autorizuar ,mer vendime per ndryshimet qe mund te pesoje statuti ,per ndryshimin e kapitalit themeltar dhe shnderrimin e shoqerise ne nje forme tjeter konform Ligjit "Per Shoqerite Tregtare" .Vendimet eAsamblese se Ortakeve evidentohen ne nje regjister.

Neni 12
Shoqeria administrohet nga Shpetim Xibraku ,ne rast se zgjerohet aktiviteti i Shoqerise si dhe rast se adminstratori nuk deshiron ta kryeje kete funksion,sipas rastit mer vendim per emerimin e nje administratori te ri.

Neni 13

VITI FINANCIAR LLOGARITE VJETORE, EKSPERTI KONTABEL.

Cdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 dhjetor .Perjashtimisht viti i pare financiar i cili do te filloje pas regjistrimit te Shoqerise ne Gjykate si person



juridik dhe pajisjen me certifikaten perkatese ne zyren e tatim taksave por do te perfundoje me 31 dhjetor te cod viti .Llogarite vjetore ,inventaret raportet mbi operacionet e vecanta te hartuara nga ekspertit kontabel i autorizuar miratohen nga Asambleja e Ortakeve. .Veprimtaria e ekspertit kontabel te autorizuar nga asambleja e Ortakeve sipas nenit 69 te ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare"

Neni 14

AKTIVITETI FINANCIAR

Ne mbyllje te cdo viti financiar behet inventari dhe llogaria vjetore ne perputhje me dispozitat ne fuqi per kontabilitetin dhe hartohet nje raport me shkrim .Dokumentat vihen ne dispozicion te ekspertit te autorizuar dhe ne perfundim miratohen nga Asambleja e Ortakeve.

Neni 15

Fitime neto te Shoqerise do te konsiderohen fitimet qe rezultojne pas zbritjes nga te ardhurat e te gjitha shpenzimeve qe kane lidhje me aktivitetin e shoqerise ,detyrimet tatimore dhe fiskale ,sigurimet shoqerore ,demtimet amortizimet , ne perputhje me legjislacionin ne fuqi .Ne perputhje me nenin 213 te ligjit per Shoqerite Tregtare nga fitimi i rezervuar gjate vitit financiar lihet menjane nje shume vlere 1-20 e cila destinohet per formimin e nje fondi " rezerve e domosdoshme"

Neni 16

Shoqeria priset me kalimin e afatit te caktuar ne statut dhe per arsye te tjera te parashikuara me ligj , Shoqeria priset para afatit me vendim te Asamblese se Ortakeve .

Neni 17

Kur shoqeria priset ajo kalon ne likujdim .Ne kete rast emrit te Shoqerise i shtohet shenimi "Shoqeri ne likujdim e siper " Shoqeria edhe gjate procesit te likujdimit vazhdon ne baze te llogarive te likujdimit .Prishja e Shoqerise eshte me pasoja per te tretet vetem pas publikimit

Neni 18

Rastet e pavlefshme te Shoqerise ose te nje akti qe ndryshon statutin si dhe bashkimi i Shoqerise behete ne perputhje me dispozitat e ligjit Per Shoqerite Tregtare .

Neni 19

Per te perfunduar procesin e likujdimit ,Asambleja e Ortakeve emerone nje ose disa likujdatore ,te cilet perfaqesojne Shoqerine .Likujduesi ka te drejte te perpiloje raportin , bilancin financiar , likujdon tek te tretet detyrimet e Shoqerise ,shet aktivat dhe tepricat ia kalon ortakeve .Ne rast se Asam,bleja e Ortakeve, nuk ka mundesi te emerone likujdues ,ai emerohet nga Gjykata.

Neni 20



Ne perfundsim te mbylljes se likujdimit ,asambleja e ortakeve vendos per bilancin financiar perfundimtar,aktin e rregullueshmerise ,administrimin nga ana e likujduesit dhe dhe heqjen e mandatit te likujduesit si dhe evidentimii likujdimit.Dokumentet e mesiperme miratohen me vendim te Asamblese se Ortakeve.

Neni 21

Kur Shoqeria likujdohet pasurite qe jane vene ne dispozicion te Shoqerise me te drejte shfrytezimi u kthehen pronareve .Mjetet finaciare te fituara s rezultat i veprimtarise se Shoqerise dhe fondet fillestare i kalojne ortakeve te shoqerise pasi te jene beerpagesat ne favor te kreditoreve

Neni 22

Mosmarveshjet qe lindin gjate punes ne shoqeri zgjidhen me mirekuptim, ne baze te ligjeve ne fuqi ne te kundert palet i drejtohen Gjykates se Rrethit.

Neni 23

Ky statut perpilohet ne kater kopje origjinale , duke patur secila kopje te njejten fuqi ligjore

NENI 24

Ky statut firmoset rregullisht nga asambleja e ortakeve konform ligjit.

THEMELUES

SHPETIM XIBRAKU

Shpetim Xibraku

REPUBLIKA E SHQIPERISE

DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr.2618 Rep

ZELIHA XIBRAKU

Zelika Xibraku

VERTETIM

Sot, me daten 25.06..2003 ne Dhomen e Noterise Tirane , para meje noteres Luljeta Kongoli ,u paraqiten personalisht : SHPETIM XIBRAKU , I biri i Fadilit , lindur me 27.10.1972 ne Tirane , banues ne Tirane , rr"Mustafa Lleshi" pll.18,.ZELIHA XIBRAKU,lindur me 1949 , banuese ne Tirane , ne adresen e mesiperme, te cilet pasi mu bene te njohur, une noteria i vertetoj nenshkrimin sipas ligjit.



**NOTERE
LULJETA KONGOLI**

Luljeta Kongoli